**Në ligatinat e zonave bregdetare** llojet shqetësuese që mësyjnë në perëndim të diellit nga monitorimet entomologjike të deritanishme kanë rezultuar *Oclerotatus caspius, Oc. detritus dhe Ae. vexans,* lloje këto mund të zhvendosen në distancë nga 20-40 km.
**Në disa zona si Gjiri i Lalzit, Divjakë, Darëzezë, Butrint** janë gjetur mushkonja *Anopheles*, vektor i transmetimit të malaries.
Gjithashtu nga të dhënat e investigimeve entomologjike në **zonat bregdetare në jug të vendit: Vrinë, Orikum, Vlorë, Divjakë, Gjiri i Lalzit dhe Shëngjin** është gjetur i pranishëm vektori i Encefalitit Japonez *Culex tritaeniorhyncus*.

Procesi i dezinsektimit edhe në vitin 2019 do të bazohet **gjerësisht** në përdorimin e agjentit biologjik *Bacillus thuringensis israelensis* **Bti,** që ka aftësi të çlirojë një endotoksinë në mjedis bazik. Ky proces ndodh në aparatin tretës të larvave të mushkonjave.
Trajtimi i bodrumeve, pusetave, gropave septike do të bëhet me barrierë fizike që është një film një-shtresor me bazë silikoni pa asnjë ndikim në mjedis dhe shëndet.

## II. Specifikimet teknike për produktet

Duke qenë se në zonën bregdetare kemi të pranishme zona të mbrojtura nga konventat kombëtare dhe ndërkombëtare, rekomandohet kontrolli biologjik me anë të agjentëve biologjik pra **përdorimi i produkteve me lëndë aktive Bti (***Bacillus thuringensis israeliensis)*.
Bti ka një veprim specifik mbi larvat e mushkonjave, të gjinisë *Aedes*, *Anopheles*, *Culex*, *Ochlerotatus*, *Culiseta*, *Uranotenia*. Enzimat toksike që çlirohen nga bacilusi kur ai gëlltitet nga organizmat ujore veprojnë me receptorët e aparatit tretës vetëm në mjedis bazik. Aparati tretës i larvave të mushkonjave ka pH nga 8 deri në 10, prandaj. ***Bti* është specifik vetëm për larvat e mushkonjave.**

**Formulimet dhe përqëndrimet lëndës aktive dezinsektuese që duhet të përdoren:**

1. Agjenti biologjik *Bacillus thuringiensis israelensis (Bti)* mikrogranula të tretshme në ujë (**WG**) me fuqi 3000 I.T.U./mg (Njësi Toksike Ndërkombëtare).
2. Agjenti biologjik *Bacillus thuringiensis israelensis (Bti)* granular (**G**) me fuqi 200 I.T.U për mg.
3. Film monomolekular është një produkt me bazë silikoni, që vepron si barrierë fizike për kontrollin e larvave të mushkonjave, i cili aplikohet në përqendrimin 1ml/m$^2$.

Bazuar në urdhërin e MSH Nr. 202, datë 23.05.2014, produktet me lëndët aktive dhe formulimet e mësipërme duhet të jenë të regjistruara të paktën në një nga vëndet e BE-së, Angli, Zvicër, Kanada, Australi ose SHBA dhe të jenë të regjistruara në ECHA (Agjensia Evropiane e

Kimikateve, organi më i madh i kimikateve në Evropë).
Në lidhje me lëndët dezinsektuese sipas formulimeve të përcaktuara më sipër, OE duhet të paraqesë etiketën dhe MSDS e produkteve (Anglisht dhe Shqip).

## III. Specifikimet teknike për teknikat e trajtimeve

1. **Teknika Cold fogging** është rekomanduar kryesisht për kontrollin e mushkonjës tigër *Ae. albopictus* mjaft e përhapur në zonat urbane. Aplikimi i kësaj teknike kërkon kushte specifike dhe experiencë për t'u aplikuar në mënyrë efikase. Kalibrimi i pajisjes mjegulluese për përdorim me lëndën aktive Bti dhe zbatimi i të gjitha specifikimeve teknike të përcaktuara është mjaft i rëndësishëm për të pasur efikasitet në trajtim. Trajtimi me këtë teknikë kryhet gjatë natës pasi ulja e temperaturës gjatë natës krahasuar me ato të ditës, ndihmon në dekantimin e grimcave të *Bti* me madhësi 80-100 mikron si dhe për të mos shqetësuar pushuesit dhe qytetarët, rekomandohet mesatarisht çdo dy javë.

**Teknika "Cold fogging"** mjegull e ftohtë, ka të bëjë me aplikimin e produktit me anë të një aparati mjegullues (nebulizator) që prodhon mjegull të ftohtë, i montuar në një kamionçinë.

- Sasia e produktit që duhet të aplikohet nga sistemi i mjegullimit duhet të jetë 100 litra/orë.
- Madhësia e piklave duhet të jetë 80–100 mikron.
- Rezervuari duhet të jetë me tank të madh me volum jo më pak se 300 litra për të realizuar trajtimin sipas zonave përkatëse për një kohë të shkurtër.
- Rezervuari duhet të jetë i pajisur me përzierës (agitator).

***Për këtë teknikë OE duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:***

- Të disponojë pajisjen mjegulluese (nebulizator) të montuar në një kamionçinë (pesha mbajtëse jo më pak se një ton, logo e dukshme e kompanisë, fenolina/ngjyra portokalli, të ketë kolaudim dhe sigurim për gjatë gjithë kohës së kontratës). Motorri i pompës duhet duhet të ketë të dukshën numrin e identifikimit (në rast defekti ose aksidenti, të lajmërohet me shkrim AK). Këto paisje mund të jenë në pronësi/qera.
- Të bëjë kalibrimin e pajisjes në fillim të sezonit të trajtimit për të aplikuar Bti WG në përqendrimin 1kg/ha, në prani të AK.
- Të printojë dhe të **ketë përpara fillimit** të aplikimit hartën përkatëse digitale të zonave që do të trajtohen, të përgatitur nga DSHP/DRSH të cilat mund të mbështeten teknikisht nga ISHP/AK.
- Shpejtësia e kamionçinës duhet të jetë shumë e ulët, jo më shumë se 10km/h.
- Trajtimi duhet të bëhet gjatë natës dhe të përfundojë përpara lindjes së diellit.
- OE duhet të monitorojë dhe të marrë parasysh kushtet klimatike përpara trajtimit.
- OE nuk duhet të bëjë trajtim nëse shpejtësia e erës i kalon 10 km/h, në përputhje me të

dhënat e Shërbimit Metereologjik shqiptar të aksesueshme on line.

- OE duhet të paraqesë pranë AK të printuar hartën e zonave para dhe pas trajtimit.
- Të bashkëpunojë me pushtetin lokal dhe komunitetin.
- OE duhet të njoftojë banorët/pushuesit një ditë përpara trajtimit**, me fletëpalosje.**

2. **Teknika Pompë me presion të lartë me Bti WG** rekomandohet për trajtimin e kanaleve dhe habitateve me vegjetacion shumë të dendur ku është gjetur kryesisht mushkonja e zakonshme *Culex pipiens* dhe mushkonja të llojeve dhe gjinive të tjera të mundshme. Kalibrimi i pompave është i rëndësishëm për të pasur efektivitet në trajtim.
**Teknika me mjetin Pompë me presion të lartë**

- Presioni i pompës duhet të jetë > 5 bar dhe prurja duhet të jetë rreth 15 litër/min.
- Rezervuari duhet të jetë i pajisur me një sistem përzieres (agitator).
- Kalibrimi i pompës me presion të lartë duhet të kryhet në fillim të sezonit në prani të AK.

***Për këtë teknikë OE duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:***

- OE duhet të disponojë pompë me presion të lartë, me rezervuar me volum jo më të vogël se 300 litra.
- Pompa duhet të kalibrohet për aplikimin e *Bti* në formulimin WG.
- Pompa me presion të lartë dhe aparati mjegulles mund të jenë të montuara në të njëjtën kamionçinë.
- Shpejtësia e kamionçinës gjatë trajtimit nuk duhet t'i kalojë 10 km/orë.
- Kamionçina duhet të jetë e pajisur me aparat GPS për të regjistruar trajtimin.
- OE duhet të bashkëpunojë me pushtetin lokal për koordinimin e punës.
- OE duhet të printojë dhe të ketë përpara fillimit të aplikimit, hartën përkatëse digitale të zonave që do të trajtohen, të përgatitur nga DSHP/DRSH, të cilat mund të mbështeten teknikisht nga ISHP/AK.
- Nëse nga procesi i monitorimit entomologjik pas 48 orëve që është kryer trajtimi, do të gjenden larva të gjalla, OE duhet ta ritrajtojë menjëherë vatrat pozitive për praninë e larvave me shpenzimet financiare të tij, që nuk mbulohen nga AK.
- Në rastin kur gjenden larva të gjalla duhet të përllogaritet përqindja e reduktimit duke u bazuar në formulën e Mulës si më poshtë. Në rast se efektiviteti në përqindje është mbi 95% nuk kryhet ritrajtim, në rast se efektiviteti në përqindje i përllogaritur me formulën e Mulës është 95% dhe më pak, trajtimi duhet të përsëritet për atë zonë dhe teknikë.
- OE duhet ti paraqesë AK të printuar hartën e zonave pas trajtimit.

$$R = 100 - \left[\left(\frac{C1}{T1}\right) x \left(\frac{T2}{C2}\right)\right] x\ 100$$

C1 – numri mesatar i larvave/dipper në stacionin e kontrollit PARA trajtimit.
C2 – numri mesatar i larvave/dipper në stacionin e kontrollit PAS trajtimit.
T1- numri mesatar i larvave/dipper në stacionet që do të trajtohen PARA trajtimit.
T2- numri mesatar i larvave/dipper në stacionet që do të trajtohen PAS trajtimit.

3. **Teknika me Pompë shpine me presion me Bti WG** rekomandohet për t'u përdorur në pellgje të përkohshme të krijuara në zona të mbrojtura, për kontrollin e larvave të mushkonjave në mbrëmje *Ochlerotatus caspius, Oc. detritus, Aedes vexans*, lloje këto mjaft shqetësuese për zhvillimin e turizmit në këto zona, *Oc. caspius* është fluturues i mirë dhe zhvendoset deri në 20km për t'u ushqyer, ndërsa *Ae. vexans* është në gjendje të zhvendoset deri në 40km. Aplikimi korrekt i teknikës është mjaft i rëndësishëm për të pasur efektivitet në trajtim. Target vendet e zhvillimit të *Cx. tritaeniorhyncus, Oc. caspius, Ae. vexans, Oc. detritus, Anopheles spp.*

**Teknika me mjetin Pompë shpine me presion**

- Pompa e shpinës duhet të ketë një volum jo më pak se 5 litra.
- Pompa duhet të ketë pipthin në dalje me një diametër Φ 1.2 mm,
- Aplikimi duhet të jetë në këndin 45$^{o}$,
- Rrjedhja duhet të jetë vetëm drejt, pa kënde në dalje.

***<u>Për këtë teknikë OE duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:</u>***

- OE duhet të disponojë pompë shpine me presion, sipas karakteristikave të mësipërme, e cila duhet të jetë e kalibruar për aplikimin e Bti në formulimin WG, në përqendrimin 1 kg/ha.
- Kalibrimi duhet të bëhet në fillim të sezonit, në prani të AK.
- OE duhet të printojë dhe të ketë përpara fillimit të aplikimit, hartën përkatëse digitale të zonave që do të trajtohen të pregatitur nga DSHP/DRSH, të cilat mund të mbështeten teknikisht nga ISHP/AK.
- OE duhet të bashkëpunojë me pushtetin lokal për të bashkërenduar punën dhe për të evidentuar të gjitha vatrat e zhvillimit të larvave.
- OE duhet të jetë i pranishëm gjatë kontrollit të stacioneve të monitorimit, 48 orë pas trajtimit bashkë me përfaqësues e DSHP/DRSH dhe ISHP (AK).
- Nëse nga procesi i monitorimit entomologjik pas 48 orëve që është kryer trajtimi, do të gjenden larva të gjalla, OE duhet ta ritrajtojë menjëherë vatrat pozitive për praninë e larvave me shpenzimet financiare të tij, që nuk mbulohen nga AK.
- Në rastin kur gjenden larva të gjalla duhet të përllogaritet përqindja e reduktimit duke u bazuar në formulën e Mulës si më poshtë. Në rast se efektiviteti në përqindje është mbi 95% nuk kryhet ritrajtim, në rast se efektiviteti në përqindje i përllogaritur me formulën e

Mulës është 95% dhe më pak, trajtimi duhet të përsëritet për atë zonë dhe teknikë.

- Në zonat pa vegjetacion, brezi i aplikimit të dezinsektimit duhet të jetë mesatarisht 8 m. Kur zona që trajtohet ka vegjetacion, kjo distancë duhet të jetë 5m.
- OE duhet ti paraqesë AK të printuar hartën e zonave pas trajtimit.

$$R = 100 - \left[\left(\frac{C1}{T1}\right) x \left(\frac{T2}{C2}\right)\right] x\ 100$$

C1 – numri mesatar i larvave/dipper në stacionin e kontrollit PARA trajtimit.
C2 – numri mesatar i larvave/dipper në stacionin e kontrollit PAS trajtimit.
T1- numri mesatar i larvave/dipper në stacionet që do të trajtohen PARA trajtimit.
T2- numri mesatar i larvave/dipper në stacionet që do të trajtohen PAS trajtimit.

4. **Teknika Atomizator shpine me motorr për lëng me Bti WG** rekomandohet të përdoret në habitate që shërbejnë për zhvillimin e mushkonjës tigër por ku është e vështirë të futet makina cold fogging dhe në zgavrat dhe të çarat e drurëve ose pemëve në vend me prani të tyre. Synohet arrijta e vendeve të zhvillimit të mushkonjës tigër. Kalibrimi i atomizatorit është mjaft i rëndësishëm për të pasur efektivitet në trajtim.

**Teknika me mjetin Atomizator shpine me motorr për lëng**

- Tanku i atomizatorit duhet të jetë jo më pak se 10 litra;
- Volumi i ajrit /orë të variojë nga 900 deri në 1300 $m^3$/orë;
- Shpejtësia minimale e ajrit në dalje të jetë > 80 m/s;
- Kalibrimi i pajisjes duhet të kryhet në fillim të sezonit.

***<u>Për këtë teknikë OE duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:</u>***

- OE duhet të disponojë Atomizator shpine me motorr për lëng, e cila duhet të jetë e kalibruar për aplikimin e Bti- së në formulimin WG, në formën e mjegullës së ftohtë.
- Kalibrimi duhet të bëhet çdo herë në fillim të sezonit në prani AK.
- OE duhet të bashkëpunojë me autoritetet lokale dhe komunitetin.
- OE duhet të printojë dhe të ketë përpara fillimit të aplikimit, hartën përkatëse digitale të zonave që do të trajtohen, të përgatitur nga AShR/ DRSh/DShP, të cilat mund të mbështeten teknikisht nga ISHP/AK.
- OE duhet të monitorojë dhe të marrë parasysh kushtet klimatike përpara trajtimit.
- OE duhet të paraqesë të printuar hartën e zonave pas trajtimit.
- OE nuk duhet të bëjë trajtim nëse shpejtësia e erës i kalon 10 km/h.
- OE duhet të paraqesë pranë AK të printuar hartën e zonave para dhe pas trajtimit.
- Të bashkëpunojë me pushtetin lokal dhe komunitetin.

5. **Teknika Atomizator shpine me motorr për granula** rekomandohet në habitate me vegjetacion të dendur, pellgje të përkohshme apo që përmbyten herë pas here si në Gjirin e

Lalëzit brezat me pisha, ligatinën e Orikumit pjesa e baltovinës, ligatina e Kunes dhe Vainit pjesa e baltovinës, ku është vështirë të depërtohet fizikisht. Target vendet e zhvillimit të *Cx. tritaeniorhyncus, Oc. caspius, Ae. vexans Oc. detritus, Anopheles spp*. të pranishme në zonat e përfshira në dezinsektim. Këto janë lloje vektorësh të njohur për rolin e tyre në trasmetimin e Encefalitit Japonez, Dirofilaris imitis, malaria etj. Kalibrimi i atomizatorit është mjaft i rëndësishëm për të pasur efektivitet në trajtim.

**Teknika me mjetin Atomizator shpine me motorr për granula**

- Tanku i atomizatorit duhet të jetë jo më pak se 10 litra.
- Volumi i ajrit /orë të variojë nga 900 deri në 1300 $m^3$/orë;
- Shpejtësia minimale e ajrit në dalje të jetë > 80 m/s.

***<u>Për këtë teknikë OE duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:</u>***

- OE duhet të disponojë Atomizator shpine me motorr për granula.
- Atomizatori i shpinës me motorr për granula duhet të kalibrohet për aplikimin e në formulimin Bti G, në përqëndrimin 10 kg/ha.
- Kalibrimi i pajisjes duhet të kryhet në fillim të sezonit në prani të AK.
- OE duhet të bashkëpunojë me pushtetin lokal dhe komunitetin.
- OE duhet të printojë dhe të ketë përpara fillimit të aplikimit, hartën përkatëse digitale të zonave që do të trajtohen, të përgatitur nga AShR/ DRSh/DShP, të cilat mund të mbështeten teknikisht nga ISHP/AK.
- OE duhet të paraqesë të printuar hartën e zonave pas trajtimit.
- Nëse nga procesi i monitorimit entomologjik pas 48 orëve që është kryer trajtimi, do të gjenden larva të gjalla, OE duhet ta ritrajtojë menjëherë vatrat pozitive për praninë e larvave me shpenzimet financiare të tij, që nuk mbulohen nga AK.
- Në rastin kur gjenden larva të gjalla duhet të përllogaritet përqindja e reduktimit duke u bazuar në formulën e Mulës si më poshtë. Në rast se efektiviteti në përqindje është mbi 95% nuk kryhet ritrajtim, në rast se efektiviteti në përqindje i përllogaritur me formulën e Mulës është 95% dhe më pak, trajtimi duhet të përsëritet për atë zonë dhe teknikë.

$$\mathbf{R = 100 - \left[\left(\frac{C1}{T1}\right) x \left(\frac{T2}{C2}\right)\right] x\ 100}$$

C1 – numri mesatar i larvave/dipper në stacionin e kontrollit PARA trajtimit.
C2 – numri mesatar i larvave/dipper në stacionin e kontrollit PAS trajtimit.
T1- numri mesatar i larvave/dipper në stacionet që do të trajtohen PARA trajtimit.
T2- numri mesatar i larvave/dipper në stacionet që do të trajtohen PAS trajtimit.

**6. Teknika me mjetin Dozator për lëng.**

Teknika dozator për lëng përdoret në rastin e trajtimit të bodrumeve, gropave septike dhe pusetave me ujë të ndenjur. Trajtimi kryhet duke hedhur solucionin e lëngshëm të filmit monomolekular në njësi matëse në mililitra ose dozues (dozator) në varësi të sipërfaqes që duhet trajtuar një herë në muaj (4 javë).
Duke qenë shumica e pusetave janë të mbyllura me kapak hekuri ose janë të izoluara ose janë të pajisura me një vrimë shumë të vogël nga ku nuk mund të monitorohen dhe shihen larvat, sugjerojmë që të trajtohen vetëm pusetat e hapura që kanë ujë të ndenjur të qëndrueshëm, uji të mos rrjedh dhe që të monitorohen lehtë me pajisjet monitoruese; si edhe ato puseta ku duket qartë që ka larva edhe nëse pajisja monitoruese nuk mund te futet. Trajtimi për pusetat e gjetura të kryhet me produktin Monomolekular film në masën 1ml për pusetë (1ml/m2). Të mos trajtohen pusetat pa uë, të thata, ato që kanë ujë të rrjedhshëm dhe pusetat që nuk dallohet se kanë ujë dhe larva.

***Për këtë teknikë OE duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:***

- OE duhet të disponojë Dozator për lëng, i cili duhet të mundësojë matjen e sasisë së duhur në mililitra të filmit monomolekular në formulimin lëng, për përdorim në përqëndrimin $1ml/m^2$.
- Veprimi rezidual, duhet të monitorohet nga AShR/ DRSh/DShP dhe AK (ISHP) në prani të OE pas 1, 2, 7, 14, 21 dhe 28 ditëve.
- Nëse nga procesi i monitorimit entomologjik pas 24 ose pas 48 orësh që është kryer trajtimi, do të gjenden larva të gjalla, OE duhet ta ritrajtojë menjëherë vatrat pozitive për praninë e larvave me shpenzimet financiare të tij, që nuk mbulohen nga AK.
- OE duhet të printojë dhe të ketë përpara fillimit të aplikimit, hartën përkatëse digitale të zonave që do të trajtohen, të përgatitur nga AShR/ DRSh/DShP, të cilat mund të mbështëten teknikisht nga ISHP/AK.
- OE duhet të bashkëpunojë me pushtetin lokal dhe komunitetin.
- OE duhet të paraqesë të printuar hartën e zonave pas trajtimit.

***IV. Kërkesat për pajisjet që duhet të disponojnë OE*** :

Që të realizojë metodat dhe teknikat e mësipërme OE duhet të disponojnë:

a. Aparat mjegullues për mjegull të ftohtë dhe Pompë me presion të lartë të montuar në një kamionçinë për lotet si më poshtë:
   i. Të paktën 1 (një) Aparat mjegullues me pompë më presion, të montuar në një kamionçinë për secilin nga lotet **1 dhe 3.**
   ii. Jo më pak se 2 (dy) Aparate mjegulluese për mjegull të ftohtë me pompë me presion, të montuara secila në kamionçinën e saj për lotin **2**.
   iii. Jo më pak se 3 (tre) Aparate mjegulluese për mjegull të ftohtë me pompë me presion, të montuara secila në kamionçinën e saj për lotin **4.**

Presioni i pompës duhet të jetë > 5 bar dhe prurja duhet të jetë rreth 15 litër/min. Rezervuari duhet të jetë i pajisur me një sistem përzierës (agitator). Kalibrimi i pompës me presion të lartë duhet të kryhet në fillim të sezonit në prani të AK.

Për këto pajisje OE ofertues duhet të paraqesë dokumentat si më poshtë:

i. Në rastin e pronësisë, OE duhet të paraqesë lejen e qarkullimit të kamionçinës, (në të cilën është montuar aparati mjegullues dhe pompa me presion të lartë) kolaudimin dhe TPL-në, përgjatë kohës së ekzekutimit të shërbimit, si dhe të paraqiten gjithashtu certifikata e pronësisë, fotot e makinës me aparatet e montuara, ku të jetë e dukshme lloji i aparateve, targa e kamionçinës dhe numri i identifikimit të motorrit të sistemit. Pesha mbajtëse e kamionçinës të jetë jo më pak se 1 (një) ton, logo e dukshme e kompanisë, fenolina/ngjyra portokalli.
ii. Në rastin kur mjetet janë në përdorim, OE duhet të paraqesë kontratën e qirasë me kohëzgjatje përgjatë periudhës së ekzekutimit të shërbimit, të shoqëruar me lejen e qarkullimit të kamionçinës, ku të jetë montuar aparati mjegullues dhe pompa me presion të lartë, si edhe faturën e blerjes/deklaratën doganore të aparatit mjegullues dhe pompës me presion të lartë, si dhe një deklaratë se do të përdorë ekzaktësisht të njëjtën lloj kamionçine, aparat mjegullues dhe pompë (me të cilën ka ofertuar), përgjatë gjithë periudhës së ekzekutimit të shërbimit. Të paraqiten gjithashtu edhe fotot e makinës me aparatet e montuara, ku të jetë e dukshme lloji i aparateve, targa e kamionçinës dhe numri i identifikimit të motorrit të sistemit.
iii. OE duhet të paraqesë data sheet/skedën teknike/katalog për të gjitha pajisjet që disponon sipas kërkesave të dhëna në specifikimet teknike.

b. Të paktën 4 (katër) Pompa shpine me presion për Lot **4** - Prefektura Vlorë.

c. Të paktën 1 (një) Atomizator shpine me motor për lëng për lot **4** - Prefektura Vlorë.

d. Të paktën 1 (një) Atomizator shpine me motorr për granula për secilin nga lotet **1** dhe **3**.

e. Të paktën 2 (dy) Atomizatorë shpine me motorr për granula për secilin nga lotet **2** dhe **4**.

f. Të paktën 3 (tre) Dozatorë MMF për secilin nga lotet **1** dhe **3.**

g. Të paktën 5 (pesë) Dozatorë MMF për Lot **2.**

h. Të paktën 6 (gjashtë) Dozatorë MMF për Lot **4.**

Për pajisjet e kërkuara në pikën 3, germat c, d, e, OE , Operatori Ekonomik duhet të paraqesë faturën e blerjes së pajisjes atomizatorit të pajisur edhe me numrin ose kodin e pajisjes. Në rastin kur pajisja (atomizator) është në përdorim, OE duhet të paraqesë kontratën e qirasë.

**V. Kërkesat për OE dhe stafin teknik**:

a. OE duhet të ketë specialistë të trajnuar/certifikuar që do të kryejnë kalibrimin e paisjeve sipas kërkesave të teknikave dhe produkteve që do të përdoren. Për këtë OE duhet të paraqesë deklaratën për personin/at përgjegjës që do të kryejë/në kalibrimin e paisjeve, të shoqëruar me dëshmi dhe/ose certifikata që vërtetojnë aftësitë teknike të tyre për kalibrimin e pajisjeve për aplikimin e produkteve të përcaktuara, duke ruajtur edhe mjedisin.
b. OE duhet të marrë përsipër të sigurojë veshjet e përshtatshme për punëtorët që do të punojnë në terren.
c. OE është përgjegjës për sigurinë e punonjësve të tij që do të kryejnë trajtimin në terren.
d. OE duhet të sigurojë mbrojtjen e mjedisit dhe të komunitetit. Në rast të dëmtimeve në mjedis dhe në komunitet, OE do të mbajë përgjegjësi sipas legjislacionit në fuqi. AK nuk mban asnjë lloj përgjegjësi për dëmin shkaktuar nga/për OE ose të tretëve.
e. OE duhet të ketë:
    - 1 (një) Drejtues teknik, 1 (një) Teknik Aplikimi dhe 2 (dy) ose me shumë aplikues, për secilin nga Lotet **1** dhe **3**;
    - 1 (një) Drejtues teknik, 2 (dy) Teknikë Aplikimi dhe 4 (katër) ose me shumë aplikues, për Lotin **2;**
    - 1 (një) Drejtues teknik, 3 (tre) Teknikë Aplikimi dhe 6 (gjashtë) ose me shumë aplikues, për Lotin **4.**

    Punonjësit e mësipërm duhet të jenë të licencuar/certifikuar. Për secilin punonjës kompania duhet të paraqesë licencën/certifikatë, kontratën e punës, CV e Drejtuesit Teknik dhe Teknikut të Aplikimit, si dhe listpagesën e-sig. Nëse, OE do të ofertojë për më shumë se një lot, vetëm Drejtuesi Teknik do të jetë 1 (një).

Nëse, OE do të ofertojë për më shumë se një lot, vetëm Drejtuesi Teknik do të jetë 1 (një).

## VI. Kërkesat për kontrollin dhe monitorimin

Të gjitha trajtimet do të monitorohen me anë të përdorimit të GPS-ve të integruar në pajisjet e aplikimit dhe mjetet lëvizëse për teknikën cold fogging dhe pompë me presion të lartë, si edhe GPS dore në rastin e pompave të shpinës me presion, atomizatorëve të shpinës me motor për lëng, atomizatorëve të shpinës me motor për granula dhe dozator për lëng. Ky sistem duhet të sigurohet nga OE.
Të dhënat e GPS do të regjistrohen në një bazë të dhënash me anë të programit GIS. Në secilën zonë do të përcaktohen stacione monitorimi, të cilat kanë rezultuar pozitive për praninë e larvave te mushkonjave. Monitorimi entomologjik dhe monitorimi i shërbimit do të kryhet në bazë të një udhëzuesi dhe protokolli pune të hartuar nga ISHP. Monitorimi entomologjik do të kryhet 24-48 orë përpara trajtimit dhe 24-48 orë pas kryerjes së trajtimit të secilës zonë apo habitat. Gjithashtu në çdo zonë do të caktohet edhe një stacion kontrolli për të bërë vlerësimin e efektshmërisë së trajtimit. Për trajtimet me monomolekula film në bodrume dhe puseta monitorimi do të bëhet para trajtimit dhe 1, 2, 7, 14, 21 dhe 28 ditë pas trajtimit nga ISHP dhe AShR/ DRSh/DShP.

- Në fillim të sezonit të trajtimeve OE duhet të kalibrojë paisjet në prani të stafit të AK.
- Përpara fillimit të çdo trajtimi grupi përfaqësues të AShR/ DRSh/DShP duhet të verifikojnë produktet për trajtim në prani të OE.
- OE për të siguruar aplikimin e procesit të dezinsektimit duhet të jetë i regjistruar dhe të sigurojë shërbimin WEB GIS me editim nga interneti për ndërtimin e hartave dixhitale. Në shërbimin WEB GIS. AShR/ DRSh/DShP dhe Autoriteti Kontraktor duhet të ketë akses të plotë për përgatitjen e hartave dixhitale për ndjekjen e ecurisë së procesit të dezinsektimit. Në momentin e lidhjes se kontratës midis OE fitues dhe AK, OE duhet të paraqesë kontratën që ka me ofruesin e shërbimit WEB GIS.
- Trajtimet duhet të jenë të gjurmuara me një aparat GPS për çdo teknikë dhe për çdo aplikues.
- OE duhet t'i sigurojë ISHP-së dhe AShR/ DRSh/DShP mundësi hyrje dhe përdorimi të sistemit WEB-GIS on-line, për të hartuar, ndjekur dhe kontrolluar procesin e aplikimit.
- OE duhet të sigurojë printimin e hartave digitale me ngjyra para dhe pas trajtimit.
- Të dhënat e regjistruara me GPS duhet të jenë të disponueshme në formatin *shape.file*, të vlefshme për përdorim në sistemin web-GIS, mbi të cilin ndërtohen hartat nga ana e AShR/ DRSh/DShP, të cilët mund të mbështeten teknikisht nga ISHP/AK.
- OE duhet të ketë ekipe në çdo prefekturë sipas loteve përkatëse për të cilat do të ofrojë shërbimin.

## VII. Planifikimi i sipërfaqeve dhe zonave për trajtim

Përcaktimi i zonave, teknikave, numrit të trajtimeve dhe sipërfaqeve për trajtim është bërë duke u bazuar në:

a. Kërkesën e AShR/ DRSh/DShP-ve;
b. Rekomandimet e ECHA, EMCA dhe Reg.528/2012 të BE mbi Produktet Biocide;
c. Rezultatet e monitorimeve entomologjike të deritanishme;
d. Llojet e habitateve në zonat bregdetare dhe urbane;
e. Llojet e mushkonjave, përhapjen dhe kapacitetin e tyre vektorial;
f. Eksperiencen e viteve pararendëse.

Zonat, sipërfaqja, teknika/mënyra e ndërhyrjes, doza e aplikimit të produktit dezinsektues, numri i trajtimeve, paraqiten në tabelën bashkangjitur ku është përllogaritur fondi limit i planifikuar për vitin 2019.

Ky përcaktim është i përafërt, pasi përcaktimi i saktë i sipërfaqeve mund të bëhet në kohën kur është i nevojshëm trajtimi i tyre, bazuar në rezultatet e monitorimeve entomologjike.

**Shtojca 10**

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

**PLANIFIKIMI I**
**KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

| Shërbim:<br>Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër | | |
|---|---|---|
| **Kontrata Nr.** | **Titulli i Kontratës** | **Përshkrim i shkurtër i kontratës** |
| **01** | | |
| **02** | | |
| **03** | | |
| **…** | | |

**Shtojca 11**

( *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit*)

## SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT

Planifikimi i zonave, teknikave, numrit të trajtimeve dhe sipërfaqeve për trajtim jepen në tabelën e mëposhtme.
Përcaktimi i saktë i sipërfaqeve do të bëhet në kohën kur është i nevojshëm trajtimi i tyre, bazuar në rezultatet e monitorimeve entomologjike dhe kërkesën e AShR/DRSh/DShP për dhënien e kontratave.

Për çdo rast të dhënies së kontratave, AK, bazuar në kërkesat e AShR/DRSh/DShP respektive, duhet të përcaktoje ne kontrate zonën, sipërfaqen e trajtimit, teknikën e trajtimit, numrin e trajtimeve dhe afatet.

Dhënia e kontratave do të bëhet nga AK, me OE fitues të secilit lot, sipas përcaktimeve në Ftesën per Ofertë e cila bazohet ne kërkesat e AShR/DRSh/DShP, duke u bazuar në çmimin për njësi të ofertës me të cilën është shpallur fitues dhe është lidhur MK.

Shërbimi që kërkohet:

Afatet e ekzekutimit:

| **Nr.** | **Zonat 2019-2020** | **Teknikat / Mënyra e ndërhyrjes** | **Lendet aktive dhe formulimi qe do te perdoret per trajtim** | **Përqëndrimi i lendës aktive** | **Siperfaqja e parashikuar** | | **Nr. i trajtimeve i parashikuar per 24 muaj** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **LOT I Prefektur: Shkodër, Lezhe** | | | | | | | |
| 1.1 | Shkoder (zone urbane) | Cold fogging | Bti WG | 1 kg/ha | 10 | ha | 20 |
| | | Atomizator shpine me motorr per granula | Bti G | 10 kg/ha | 1.3 | ha | 24 |
| | | Pompë me presion të lartë | Bti WG | 1 kg/ha | 1 | ha | 24 |
| | | Dozator per leng per bodrume dhe puseta | Monomolekular film | 1ml/m2 | 2300 | m2 | 12 |
| 1.2 | Velipoje | Cold fogging | Bti WG | 1 kg/ha | 8 | ha | 20 |
| | | Pompë me presion të lartë | Bti WG | 1 kg/ha | 2 | ha | 24 |
| | | Atomizator shpine me motorr per granula | Bti G | 10 kg/ha | 2 | ha | 24 |
| 1.3 | Lezhe (zone | Cold fogging | Bti WG | 1 kg/ha | 5 | ha | 20 |
| | | Dozator per leng per | Monomoleku | 1ml/m2 | 1080 | m2 | 12 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | urbane) | bodrume dhe puseta | lar film | | | | |
| | | Pompë me presion të lartë | Bti WG | 1 kg/ha | 0.9 | ha | 24 |
| | | Atomizator shpine me motorr per granula | Bti G | 10 kg/ha | 0.8 | ha | 24 |
| 1.4 | Shengjin | Cold fogging | Bti WG | 1 kg/ha | 7 | ha | 20 |
| | | Atomizator shpine me motorr per granula | Bti G | 10 kg/ha | 3 | ha | 24 |
| | | Dozator per leng per bodrume dhe puseta | Monomolekular film | 1ml/m2 | 2550 | m2 | 10 |
| **LOT II Prefektura Tirane, Durres** | | | | | | | |
| 2.1 | Tirane (zone urbane) | Cold fogging | Bti WG | 1 kg/ha | 40 | ha | 24 |
| | | Dozator per leng per bodrume dhe puseta | Monomolekular film | 1ml/m2 | 6000 | m2 | 12 |
| | | Pompë me presion të lartë | Bti WG | 1 kg/ha | 2 | ha | 24 |
| 2.2 | Plazhi Golem-Qerret | Cold fogging | Bti WG | 1 kg/ha | 12 | ha | 24 |
| | | Pompë me presion të lartë | Bti WG | 1 kg/ha | 2 | ha | 24 |
| | | Atomizator shpine me motorr per granula | Bti G | 10 kg/ha | 1 | ha | 24 |
| | | Dozator per leng per bodrume dhe puseta | Monomolekular film | 1ml/m2 | 3200 | m2 | 12 |
| 2.3 | Plazhi Spille | Cold fogging | Bti WG | 1 kg/ha | 5 | ha | 24 |
| | | Pompë me presion të lartë | Bti WG | 1 kg/ha | 2 | ha | 24 |
| 2.4 | Shën Pjetër | Pompë me presion të lartë | Bti WG | 1 kg/ha | 2 | ha | 24 |
| 2.5 | Gjiri i Lalzit | Atomizator shpine me motorr per granula | Bti G | 10 kg/ha | 4 | ha | 24 |
| | | Pompë me presion të lartë | Bti WG | 1 kg/ha | 0.5 | ha | 24 |
| | | Cold fogging | Bti WG | 1 kg/ha | 3 | ha | 24 |
| | | Dozator per leng per bodrume dhe puseta | Monomolekular film | 1ml/m2 | 30 | m2 | 12 |
| 2.6 | Durres (zone urbane) dhe Plazhi Plepa | Cold fogging | Bti WG | 1 kg/ha | 20 | ha | 24 |
| | | Dozator per leng per bodrume dhe puseta | Monomolekular film | 1ml/m2 | 6200 | m2 | 12 |
| | | Atomizator shpine me motorr per granula | Bti G | 10 kg/ha | 3 | ha | 24 |
| | | Pompë me presion të lartë | Bti WG | 1 kg/ha | 5 | ha | 24 |
| **Loti III Prefektura Fier** | | | | | | | |
| 3.1 | Divjake dhe plazh | Cold fogging | Bti WG | 1 kg/ha | 15 | ha | 20 |
| 3.2 | Fier (zone urbane) | Cold fogging | Bti WG | 1 kg/ha | 20 | ha | 24 |
| | | Pompë me presion të lartë | Bti WG | 1 kg/ha | 5 | ha | 24 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Dozator per leng per bodrume dhe puseta | Monomolekular film | 1ml/m2 | 2700 | m2 | 12 |
| 3.3 | Darezeze, Plazhi i Semanit | Cold fogging | Bti WG | 1 kg/ha | 5 | ha | 20 |
| | | Pompë me presion të lartë | Bti WG | 1 kg/ha | 5 | ha | 20 |
| | | Atomizator shpine me motorr per granula | Bti G | 10 kg/ha | 2 | ha | 20 |
| | | Dozator per leng per bodrume dhe puseta | Monomolekular film | 1ml/m2 | 100 | m2 | 12 |
| **Loti IV Prefektura Vlorë** | | | | | | | |
| 4.1 | Vlore (zone urbane - plazh-Narte-Zverrnec) | Cold fogging | Bti WG | 1 kg/ha | 40 | ha | 24 |
| | | Dozator per leng per bodrume dhe puseta | Monomolekular film | 1ml/m2 | 4260 | m2 | 12 |
| | | Atomizator shpine me motorr per granula | Bti G | 10 kg/ha | 0.16 | ha | 24 |
| | | Pompë me presion të lartë | Bti WG | 1 kg/ha | 7.3 | ha | 24 |
| 4.2 | Rradhime | Pompë me presion të lartë | Bti WG | 1 kg/ha | 1 | ha | 24 |
| 4.3 | Orikum | Pompë me presion të lartë | Bti WG | 1 kg/ha | 2.3 | ha | 24 |
| | | Pompë shpine me presion | Bti WG | 1 kg/ha | 3 | ha | 24 |
| | | Atomizator shpine me motorr per granula | Bti G | 10 kg/ha | 3 | ha | 24 |
| | | Cold fogging | Bti WG | 1 kg/ha | 5 | ha | 24 |
| | | Dozator per leng per bodrume dhe puseta | Monomolekular film | 1ml/m2 | 50 | m2 | 12 |
| 4.4 | Dhermi-Drimadh | Cold fogging | Bti WG | 1 kg/ha | 8 | ha | 24 |
| 4.5 | Jal | Cold fogging | Bti WG | 1 kg/ha | 2 | ha | 24 |
| | | Dozator per leng per bodrume dhe puseta | Monomolekular film | 1ml/m2 | 10 | m2 | 12 |
| 4.6 | Himare-Livadh | Cold fogging | Bti WG | 1 kg/ha | 5 | ha | 24 |
| | | Dozator per leng per bodrume dhe puseta | Monomolekular film | 1ml/m2 | 1153 | m2 | 12 |
| 4.70 | Qeparo | Cold fogging | Bti WG | 1 kg/ha | 4 | ha | 24 |
| | | Dozator per leng per bodrume dhe puseta | Monomolekular film | 1ml/m2 | 20 | m2 | 12 |
| 4.8 | Borsh | Cold fogging | Bti WG | 1 kg/ha | 4 | ha | 24 |
| | | Pompë me presion të lartë | Bti WG | 1 kg/ha | 2 | ha | 24 |
| 4.9 | Bunec | Cold fogging | Bti WG | 1 kg/ha | 1 | ha | 24 |
| 4.10 | Çukë | Cold fogging | Bti WG | 1 kg/ha | 1 | ha | 24 |
| | | Atomizator shpine me motorr per granula | Bti G | 10 kg/ha | 1 | ha | 24 |
| 4.11 | Ksamil | Cold fogging | Bti WG | 1 kg/ha | 10 | ha | 24 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Dozator per leng per bodrume dhe puseta | Monomolekular film | 1ml/m2 | 30 | m2 | 12 |
| 4.12 | Sarande (zone urbane) | Cold fogging | Bti WG | 1 kg/ha | 20 | ha | 24 |
| | | Dozator per leng per bodrume dhe puseta | Monomolekular film | 1ml/m2 | 500 | m2 | 12 |
| 4.13 | Parku Kombetar i Butrintit dhe zonat perreth (Vrine) | Pompë shpine me presion | Bti WG | 1 kg/ha | 5 | ha | 24 |
| | | Atomizator shpine me motorr per leng | Bti WG | 1 kg/ha | 1 | ha | 24 |

Afatet e ekzekutimit: Percaktohen ne kontrate

**Afatet e dhënies së kontratave: Duke filluar menjëherë pas lidhjes së Marrëveshjes Kuadër me afat 24 (njëzetë e katër) muaj.**

**Shtojca 12**

( *Shtojcë për t'u plotëesuar nga Autoriteti Kontraktor)*

## TERMAT E REFERENCËS

***Objekti dhe qëllimi i shërbimeve***:
Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane me qëllim kontrollin e mushkonjave.

***Detyrat:***

1. Kryerja e procesit të dezinsektimit sipas kërkesës së AK, brenda 24-48 orëve nga paraqitja e kërkesës për kryerjen e këtij shërbimi.
2. Raportimi i punës së kryer nga OE/të fituese.
3. Kryerja e procesit të dezinsketimit bazuar në specifikimet teknike dhe sipas teknikave të përshkruara në mënyrë të hollësishme në tabelën e specifikimeve teknike të detajuar.

***Shpërndarja:***
Grafikut i lëvrimit do të jetë në funksion të kërkesave për ndërhyrje sipas rezultateve të monitorimeve entomologjike. Numri total i përafërt i trajtimeve është përcaktuar në tabelën për perllogaritjen e fondit limit.

***Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve***
Shërbimi do të kryhet në vendet si më poshtë:

Loti. 1 **Prefektura Shkodër-Lezhë:**

- Shkodër (zonë urbane)
- Velipojë
- Lezhë (zonë urbane)
- Shëngjin

Loti. 2 **Prefektura Tiranë - Durrës**

- Tiranë (zonë urbane)
- Plazhi Golem-Qerret
- Plazhi Spille
- Shën Pjetër
- Gjiri i Lalzit
- Durrës (zonë urbane) dhe Plazhi Plepa

Loti. 3: **Prefektura Fier**

- Divjakë dhe plazh
- Fier (zonë urbane)

- Darzezë, Plazhi i Semanit

Loti. 4 **Prefektura Vlorë**

- Vlorë (zonë urbane-plazh-Nartë-Zvërnec)
- Rradhimë
- Orikum
- Dhërmi-Drimadh
- Jalë
- Himarë-Livadh
- Qeparo
- Borsh
- Bunec
- Çukë
- Ksamil
- Sarandë (zonë urbane)
- Parku Kombëtar i Butrintit dhe zonat përreth (Vrinë).

**Shtojca 13**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor*]

## NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR[1]

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme :

______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________
______________________________________________________________________________

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
**< Emri >**

**Shtojca 14**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor*]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**

[Data________]

Për: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]*
Procedura e prokurimit:
Numri i referencës së procedurës/lotit:
Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]*
Publikime të mëparshme *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*
Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme
Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:
1.___________________________________ ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*
Vlera _______________________________
*(me numra dhe fjalë)*

2.___________________________________ ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*
Vlera ____________________________
*(me numra dhe fjalë)*
Etj.____________________________

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:
1.___________________________________ ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*
2.___________________________________ ______________________________
*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:
________________________________________________________________________________
________________________________________________________________________________
________________________________________________________________________________

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *[emri dhe adresa e ofertuesit të*

*shpallur fitues]* se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej *[shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*/pikët totale të marra *[_____]*është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]* sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda ____________ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë ______________________________

Ankesa: ka ose jo______________
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë ___________________________

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

**Shtojca 15**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër*]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR**

*[Data]*

Për: *[Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]*

1.________________________________________

*2.* ________________________________________

*3.*________________________________________

* * *

Procedura e prokurimit: ______________________

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: d oferta ekonomikisht më e favorshme dçmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1.__________________________________ ______________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera ______________________________

*(me numra dhe fjalë)*

2.__________________________________ ______________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____________________________

*(me numra dhe fjalë)*

Etj.____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1.__________________________________ ______________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

2.__________________________________ ______________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

_______________________________________________________________________________

_______________________________________________________________________________

_______________________________________________________________________________

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se jane identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1.________________________________ ____________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _______________/ Pikët totale të marra ____

*(me numra dhe fjalë)*

2.________________________________ ____________________________

*Emri i plotë i shoqërisë* *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera ___________/Pikët totale të marra ____

*(me numra dhe fjalë)*

Etj.__

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë *[emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit]*, brenda ____________ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____________________________

Ankesa: ka ose jo______________

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë ___________________________

**[Titullari i autoritetit kontraktor]**

**Shtojca 16**

## KUSHTET E PËRGJITHSHME TE KONTRATES
## Shërbimet – Procedura e Hapur

### Neni 1 Qëllimi

1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Shërbimeve të prokuruara me anë të procedurës së hapur.

1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërise parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.

1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.

1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.

Kushtet e kontratës, përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

### Neni 2 Përkufizime

